

## Medalja Presidenciale nga Izraeli - çmim për gjithë kombin shqiptar

Shkruan: Lulëzim ETEMAJ

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com

Gazeta "Epoka e re"



**ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# SKANDALOZE: SPECIALJA I REFEROHET KOSOVËS 'KOSOVO I METOHIJA', REAGIME TË ASHPRA NË PRISHTINË

FAQE 4-5



## II. FAKTET

- Pas shqyrtimit të korrespondencës së dorëzuar nga ankuesi, si dhe të parashtrimeve të Prokurorit të Specializuar, faktet mund të përmbledhen si vijon.
- Më 11 nëntor 2022, ankuesi u intervistua nga dy punonjës të ZPS-së.
- Në fillim të intervistës, njëri prej punonjësve, gjatë leximit të një dokumenti, iu referua Republikës së Kosovës me fjalët 'Kosovo i Metohija' ('Kosovë dhe Metohi').
- Në atë moment, ankuesi nuk ngriti ndonjë kundërshtim dhe shqetësim në lidhje me përdorimin e shprehjes 'Kosovë dhe Metohi', pasi u këshillua të mos e bënte këtë nga mbrojtësi i tij. Megjithatë, në fund të intervistës, ai shprehu shqetësimin e tij për përdorimin e kësaj shprehjeje në dokumentacion.


Dhomat e Specializuara të Kosovës në një dokument kanë përdorur termin "Kosovo i Metohija". Kjo ka ngjallur reagime të ashpra në Kosovë nga avokatët, deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe përfaqësuesit e partive politike.

Avokati Ardian Bajraktari ka theksuar se fakti se procesi gjyqësor në Dhomat e Specializuara ishte i manipuluar me "prova" nga shteti serb ka qenë diçka që e është thënë në vazhdimësi. Ndërkaq deputetët e

Kuvendit të Kosovës kanë thënë se ky veprim i Speciales është një akt i qëllimshëm, i motivuar politikisht, që përbën jo vetëm një fyerje të rëndë për qytetarët e Republikës së Kosovës, por edhe sfidim i institucioneve dhe shtetit tonë

## A ËSHTË VONË PËR BISEDIME PËR QEVERINË E RE?

F. 3




## ROLI I SINJALIZUESVE, MJET I FUQISHËM PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

F. 7



## AKTUALE



### BE-JA DO T'I PEZULLOJË TARIFAT PËR MALLRAT AMERIKANE

F. 2

### LËVIZJA VETËVENDOSJE PRETENDON SE I KA NUMRAT PËR FORMIMIN E QEVERISË

F. 3

### "KAM FRIKË PËR TË ARDHMEN E FËMIJËVE", KOSOVA PRIN NË RAJON ME NIVELIN E METANIT NË AJËR

F. 5

## EKONOMI



### BERZH-I DHE BE-ja PREZANTOJNË PROGRAMIN PREJ 377 MILIONË EURO PËR DIGJITALIZIMIN E NVM-ve NË BALLKANIN PERËNDIMOR

F. 8

### BIZNESET ZËSHËM KUNDËR SHITRENJTIMIT TË RRYMËS

F. 8

## SPORT



### FFK-ja DHE KOMUNA E PRISHTINËS NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM PËR ORGANIZIMIN E LIGËS SË SHKOLLAVE

F. 10

**RENOVA**  
PUTZ

Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.

NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
[info@kolegji.biznesi.com](mailto:info@kolegji.biznesi.com)  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# BE-ja do t'i pezullojë tariffat për mallrat amerikane

**BRUKSEL, 10 PRILL** - Komisioni Evropian njoftoi të enjten se do t'i pezullojë për 90 ditë masat hakmarrëse kundër tarifave të reja nga Shtetet e Bashkuara, pasi presidenti Donald Trump i pezulloi fillimisht tariffat e tij dhe la hapësirë për arritjen e një zgjidhjeje përmes bisedimeve. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se komisioni, i cili merret me tregtinë për 27 vendet e bllokut, "e mori parasysh njoftimin e presidentit Trump".

Tarifat e reja të BE-së ndaj mallrave amerikane në vlerë të 20.9 miliardë eurove do të pezullohen për 90 ditë, sepse "ne duam t'u japim mundësi bisedimeve", tha ajo në një komunikatë.

Megjithatë, ajo paralajmëroi: "Nëse bisedimet nuk janë të kënaqshme, kundërmasat tona do të hyjnë në fuqi".

Ditë më parë, Trumpi vendosi tarifa prej 20 për qind ndaj mallrave nga BE-ja, si pjesë e tarifave të tij të mëdha ndaj partnerëve tregtarë nga e gjithë bota. Megjithatë, të mërkurën ai njoftoi se do t'i pezullojë ato për 90 ditë, për t'u dhënë mundësi vendeve të gjejnë një zgjidhje përmes bisedimeve.

Pezullimi i tarifave të Trumpit nuk vlen për Kinën. Trump e rriti tarifën ndaj importeve kineze në

125% të mërkurën vonë.

Von der Leyen e përshkroi pezullimin e tarifave reciproke nga Trump si "hap të rëndësishëm drejt stabilizimit të ekonomisë globale. "Kushtet e qarta dhe të parashikueshme janë thelbësore që tregtia dhe zinxhirët e furnizimit të funksionojnë", tha ajo.

Para njoftimit të Trumpit të mërkurën, vendet anëtare të BE-së kishin votuar për të miratuar tarifa hakmarrëse ndaj mallrave amerikan në vlerë prej 23 miliardë dollarësh, si përgjigje ndaj tarifave të Trumpit prej 25 për qind për çelikun dhe aluminin e importuar nga blloku.

BE-ja, partnerja më e madhe tregtare e SHBA-së, i përshkroi ato si "të paarsyeshme dhe të dëmshme".

Tarifat pritej të hynin në fuqi në faza të ndryshme, disa më 15 prill, të tjera më 15 maj dhe 1 dhjetor. Komisioni Evropian nuk dha ndonjë listë të mallrave të prekura.

Megjithatë, hyrja e tyre në fuqi është pezulluar të enjten për 90 ditë, siç njoftoi von der Leyen.

Anëtarët e BE-së - bllokut më të madh tregtar në botë e kanë përsëritur parapëlqimin e tyre për një marrëveshje të negociuar për t'i zgjidhur çështjet tregtare.



Më herët, shefja e degës ekzekutive të BE-së që negocion marrëveshje dhe mosmarrëveshje tregtare në emër të vendeve anëtare, tha se Evropa synon të ketë partneritete të shumëfishta

tregtare. Ajo tha se BE-ja do të vazhdojë "të angazhohet me vende që përbëjnë 87% të tregtisë globale dhe që ndajnë qëndrimin tonë për një shkëmbim të lirë dhe të hapur të mallrave, shërbimeve

dhe ideve", si dhe për t'i hequr barrierat ndaj tregtisë brenda tregut të saj të përbashkët. "Së bashku, evropianët do të dalin më të fortë nga kjo krizë", tha von der Leyen.

# Trump e kërcënon sërish Iranin me përdorim të forcës ushtarake

**UASHINGTON, 10 PRILL** - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka kërcënuar përsëri se do ta përdorë forcën ushtarake, nëse Irani nuk pajtohet për t'i dhënë fund programit të vet bërthamor dhe theksoi se Izraeli do të jetë "lider" i çfarëdo sulmi të mundshëm.

Trump tha për gazetarë të mërkurën në mbledhje në Shtëpinë e Bardhe se, "nëse është e nevojshme", Shtetet e Bashkuara do ta përdorin forcën ushtarake "patjetër".

Ai e tha këtë pasi u pyet për bisedimet mes zyrtarëve amerikanë dhe atyre iranienë që do të zhvillohen këtë fundjavë në Oman. "Ne kemi kohë", tha Trump, duke shtuar se nuk ka ndonjë afat të përcaktuar për përfundimin e bisedimeve SHBA-Iran. "Kur nisni bisedimet, e kuptoni nëse po ecin mirë apo jo. Dhe, unë do të thosha që përfundimi do të vijë kur të mendoj se ato nuk po ecin mirë. Pra, është thjesht një ndjesi", tha Trump.

Trump njoftoi për bisedimet më 8 prill gjatë një takimi në Zyrën Ovale me kryeministrin izraelit, Benjamin Netanyahu.

Netanyahu tha se mbështet përpjekjet diplomatike të Trumpit për të arritur



marrëveshje me Iranin. Ai shtoi se Izraeli dhe SHBA-ja ndajnë të njëjtin synim: të sigurohen që Irani të mos zhvillojë ndonjë armë bërthamore.

Trump tha se, nëse përdorimi i forcës ushtarake bëhet i nevojshëm, "Izraeli do të jetë goxha i përfshirë, natyrisht".

Të dyja palët e kanë paraqitur takimin në Oman si takim eksplorues për të parë nëse mund të zhvillohen negociata.

Trump tha se bisedimet do të jenë "të drejtpërdrejta", ndërsa

Irani i ka përshkruar ato si bisedime "të tërthorta".

Trump tha se Shtetet e Bashkuara nuk do të "kërkojnë shumë" në këto bisedime, duke përsëritur qëndrimin e tij të njohur se Irani "nuk mund të ketë armë bërthamore".

Shtetet e Bashkuara janë gjithnjë e më të shqetësuara pasi Teherani duket më afër se kurrë zotërimit të një arme bërthamore. Irani ka këmbëngulur prej kohësh se programi i tij bërthamor ka

vetëm qëllime paqësore.

Në vitin 2015, Shtetet e Bashkuara dhe fuqitë e tjera botërore arritën marrëveshje gjithëpërfshirëse bërthamore që kufizonte pasurimin e uraniumit nga Irani në këmbim të lehtësimit të sanksioneve ekonomike.

Por, Trump e tërhoqi në mënyrë të njëanshme SHBA-në nga marrëveshja në vitin 2018, duke e quajtur atë si "marrëveshjen më të keqe ndonjëherë".

Sekretari amerikan i Mbrojtjes,

Pete Hegseth, shprehu shpresën se bisedimet SHBA-Iran mund të përfundojnë në mënyrë paqësore, pasi Reuters raportoi më 9 prill se deri në gjashtë bombardues B-2 ishin zhvendosur në një bazë ushtarake SHBA-Britani në ishullin Diego Garcia në Oqeanin Indian.

Kur u pyet nëse bombarduesit B-2 ishin mesazh për Iranin, Hegseth tha: "T'ua lëmë atyre të vendosin".

Ai i përshkroi bombarduesit si "aset të shkëlqyer", duke u thënë gazetarëve gjatë një vizite në Panama se ata dërgojnë "mesazh për të gjithë".

Departamenti amerikan i Thesarit vendosi të mërkurën sanksione të reja që synojnë programin bërthamor të Iranit. Pesë entitete dhe një person me bazë në Iran u goditën me sanksione të reja në lidhje me mbështetjen e tyre të dyshuar për programin bërthamor të Iranit, tha Departamenti.

Duke folur për gazetarët në Shtëpinë e Bardhë, Trump tha se populli iranian "është i jashtëzakonshëm", por Qeveria është "regjim i ashpër". "Unë dua që Irani të jetë i madh", tha Trump. "E vetmja gjë që nuk mund të kenë është një armë bërthamore. Ata e kuptojnë këtë".

# A ËSHTË VONË PËR BISEDIME PËR QEVERINË E RE?

**PRISHTINË, 10 PRILL** - Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit e ka pranuar se nuk mund ta formojë Qeverinë e re të Kosovës pa përfshirjen e një partie shqiptare - opSION që më herët e kishte përjashtuar, duke thënë se preferonte një ekzekutiv vetëm me pakicat joserbe. Megjithatë, njohësit thonë se partia e Kurtit është vonuar në nisjen e bisedimeve për koalicionin qeverisës, teksa edhe përfshirja e një partie më të vogël shqiptare në ekzekutiv, sipas tyre, do të prodhonte një qeveri të brishtë.

Fituesja e zgjedhjeve të 9 shkurtit, Lëvizja Vetëvendosje nuk do të mund ta formojë qeverinë pa një koalicion me partitë shqiptare. Ky subjekt nuk e ka mbështetjen e plotë të partive joshumicë, por edhe sikur ta kishte, kjo nuk do të mjaftonte për ta formuar ekzekutivin.

Këtë fakt e ka pranuar të martën nënkryetari i LV-së, Glauk Konjufca, që tha se formimi i qeverisë së re s'mund të bëhet pa përfshirjen e partive shqiptare në një koalicion qeverisës.

Sipas tij, aktualisht ekzistojnë dy skenarë: votimi i një qeverie të re deri në zgjedhjen e presidentit të ri - prill 2026 - apo votimi i një ekzekutivi afatgjatë. Për të dy skenarët kërkohen 61 vota të deputetëve.

LV-ja e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, ka fituar 48 ulëse në Kuvend, Partia Demokratike e Kosovës, 24, Lidhja Demokratike e Kosovës 20 dhe koalicioni Aleanca për

Ardhmërinë e Kosovës me Nisma Socialdemokrate ka tetë deputetë.

Kurti e ftoi për bisedime LDK-në e udhëhequr nga Lumir Abdixhiku, por oferta u refuzua. Gjatë fushatës, Kurti nuk i ka kursyer fjalët për këtë parti dhe si duket LDK-ja këtë gjë nuk e ka harruar. Po ashtu, LV-ja kishte thënë se preferon një qeveri vetëm me pakicat joserbe.

Politologu Dritëro Arifi vlerëson se LV-ja ka "humbur kohë", pasi është dashur t'i fillojë bisedimet me partitë e tjera parlamentare për formimin e qeverisë së re menjëherë pas zgjedhjeve parlamentare. "Nga këndvështrimi im, është dashur që më 10 shkurt të fillojnë negociatat me partitë parlamentare, që të shohin se në cilat pikat pajtohen nga aspekti programor. Por, LV-ja ka bërë të kundërtën", thotë ai.

Ai beson se nevojitet "një koalicion më i madh shqiptar", për ta krijuar "një momentum të mirë për t'i bërë ballë edhe ndryshimeve të mëdha gjeopolitike që po ndodhin, por edhe reformave që janë të rëndësishme për mirëqenien e qytetarit".

Emir Abrashi nga organizata joqeveritare Demokracia Plus thekson se një qeveri e re mund të formohet me mbështetjen e komuniteteve pakicë joserbe, vetëm nëse edhe Nisma e Fatmir Limajt bëhet pjesë e koalicionit qeverisës.

Për dallim nga partitë e tjera shqiptare - që legjislaturën e kaluar ishin në opozitë - Limaj



ka thënë se nuk ka vija të kuqe për asnjë parti. As PDK s'ka vija të kuqe, por është shprehur se preferon një ekzekutiv pa LV-në.

Megjithatë, Abrashi thekson se një qeveri e tillë nuk do të ishte e qëndrueshme dhe do të përballej me vështirësi në miratimin e ligjeve në Kuvend. "Pyetja e parë e madhe me të cilën do të përballej ajo do të ishte zgjedhja e presidentit vitin e ardhshëm," thotë ai, duke kujtuar se për zgjedhjen e presidentit kërkohen 80 vota të deputetëve - në dy rundet e para, e më pas kërkohen vetëm 61.

"Mbështetja e njëres prej partive më të mëdha opozitare do të jetë e domosdoshme, përndryshe do të shpallen zgjedhje të jashtëzakonshme. Megjithatë, retorika e Kurtit në të kaluarën lë pak hapësirë për marrëveshje", thekson Abrashi. Në Kuvendin e Kosovës, nga 120 ulëse, 20 janë të rezervuara për komunitetet joshumicë: 10 për komunitetin serb dhe 10 për

komunitetet e tjera.

As të 10 votat e komuniteteve joserbe, që tradicionalisht e kanë mbështetur koalicionin qeverisës, Kurti s'i ka të sigurta, edhe pse shumica kanë thënë se do ta votonin një ekzekutiv të udhëhequr nga ai.

E nëntë votat që i ka Lista Serbe, as që merren në konsideratë. Kjo parti, që nga themelimi i saj më 2013, ka qenë pjesë e të secilës qeveri, pasi ka fituar gjithmonë të gjitha ulëset e rezervuara për serbët.

Kësaj radhe ekziston bazë ligjore që Lista Serbe të përjashtohet nga qeveria, pasi një deputet e ka fituar Partia serbe për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë e Nenad Rashiqit. Abrashi vlerëson se Lista Serbe nuk do të luajë rol të rëndësishëm në formimin e qeverisë së re dhe si arsye përmend përfshirjen e drejtpërdrejtë të ish-nënkryetarit të saj, Millan Radoiqiq, në sulmin e armatosur në Banjskë.

Ai shton se Lista Serbe nuk

është partnere e besueshme, sepse prej më shumë se dy vjetësh i bojkoton institucionet e Kosovës. "Është imperativ që komuniteti serb të gjejë një mënyrë për përfaqësim më të shëndetshëm në institucionet e Kosovës, në mënyrë që të shmanget një skenar ku ndonjë parti e madhe politike në Kosovë mendon se nuk është e mundur asnjë lloj bashkëpunimi me përfaqësuesit e tyre", thekson ai. Sipas Kushtetutës së Kosovës, një post ministri në Qeverinë është i rezervuar për komunitetin serb dhe një tjetër për komunitetet tjera joserbe. Nëse ekzekutivi më shumë se 12 ministri, atëherë emërohet edhe një ministër tjetër nga radhët e komuniteteve joshumicë.

Zgjedhja e këtyre ministrave bëhet në konsultim me partitë parlamentare. Nëse emërohet dikush jashtë partive parlamentare, atëherë kërkohet miratimi nga shumica e deputetëve nga komuniteti që i përket ministri.

Nëse LV-ja s'arrin t'i sigurojë 61 vota, atëherë është në dorën e presidentes Vjosa Osmani që të mandatojë partinë që e siguron se i ka votat për ekzekutivin. PDK-ja ka thënë se është e gatshme për këtë përgjegjësi, nëse i vjen radha. Por, edhe nëse mandatar i dytë dështon, atëherë kosovarët sërish do t'iu drejtohen kutive të votimit. Por, para zgjedhjes së Qeverisë, fillimisht le të presim zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve të Kuvendit të Kosovës.

## LËVIZJA VETËVENDOSJE PRETENDON SE I KA NUMRAT PËR FORMIMIN E QEVERISË

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 10 PRILL** - Anëtarë të Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët janë regjistruar të enjten si deputetë në Kuvendin e Kosovës, janë deklaruar të bindur të enjten se ky subjekt i ka numrat për formimin e qeverisë.

Hekuran Murati, i cili është regjistruar si deputet në Kuvendin e Kosovës, ka thënë se i kanë numrat për ta formuar qeverinë. "Patjetër që po [i kemi numrat e qeverisë]. 61 i kërkon Kushtetuta, sa më shumë, sa ma mirë", ka thënë ai.

Në zgjedhjet e 9 shkurtit, LV-ja mori 48 mandate, numër ky i pa mjaftueshëm për të qeverisur e vetme në Kosovë. Edhe Halil Thaçi deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje ka thënë se Kurti do të jetë kryeministër e Glauk Konjufca kryeparlamentar. "Po shpresoj që do ta bëjmë edhe pa PDK-në edhe kryeministër do të jetë

Kurti dhe kryeparlamentar Glauk Konjufca. Ashtu me vota, 63 vota", ka thënë ai pasi u regjistrua si deputet.

Ndërsa ministrja në detyrë e Drejtësisë, Albulena Haxhiu nuk është përgjigjur sa i përket ftesës për partitë opozitare. "Para dy dite kam dhënë të gjitha deklaratimet rreh këtyre çështjeve, nuk kam diçka për të shtuar", ka thënë Haxhiu.

Po ashtu edhe Agim Bahtiri nga Lëvizja Vetëvendosje, tani deputet në Kuvendin e Kosovës, ka thënë se i kanë numrat për ta formuar qeverinë. "Unë mendoj se po. Numrat janë të deputetëve, të cilët janë 61 e më shumë", ka thënë Bahtiri.

Albin Kurt të enjten derisa u regjistrua si deputet nuk iu përgjigj medieve sa i përket formimit të qeverisë së re. Dy ditë më parë, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, njëherësh nënkryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, tha se nuk beson se është i mundur formimi i



qeverisë së re pa përfshirjen në koalicionin qeverisës të partive opozitare.

Konjufca tha se Vetëvendosja ka pasur synim që në zgjedhjet e 9 shkurtit të fitonte 500 mijë vota në mënyrë që të drejtojë e vetme qeverinë e ardhshme. Por, sipas tij, rezultati zgjedhor ka treguar se një gjë e tillë nuk është e mundshme. "E kemi pasur qëllimin [t'i sigurojmë] 500 mijë vota. Nuk i kemi arritur ato. Tash është një skenar tjetër.

Është skenari B", ka deklaruar Konjufca pas një takimi me përfaqësuesit e partive politike, një javë para mbajtjes së seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës.

Konjufca tha se aktualisht ekzistojnë dy skenarë: i pari, votimi i një qeverie deri në zgjedhjen e presidentit të ri; dhe i dyti, votimi i një qeverie të re afatgjatë.

"Sa i përket kryetarit të Kuvendit, LV-ja ende nuk e ka dhënë emrin

e kryetarit të Kuvendit, për arsye se mendoj se të gjitha pozitat sa i përket përbërjes së re të mazhorancës që pastaj do të shndërrohet në qeveri, u nënshtrohen disa principeve e një prej tyre është përpjekja për ta themeluar qeverinë. Kur jemi te qeveria është e pamundur të mos themelohet një koalicion që krijon mazhorancën e aftë për të zgjedhur me 61 vota një qeveri të re. Të gjitha pozicionet, përfshirë atë të kryetarit të Kuvendit, i nënshtrohen këtij principi", ka thënë Konjufca.

Kryetari i Vetëvendosjes, Albin Kurti, i ka dërguar një letër kryetarit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, për të diskutuar për formimin e institucioneve, Kuvendit dhe Qeverisë, por ky e refuzoi ftesën e Kurtit.

Por në përgjigje, kreu i LDK-së theksoi se gjuha e LV-së karshi LDK-së ka pamundësuar bashkëpunimin e mundshëm në mes të këtyre dy taborëve politikë, për formimin e qeverisë së re.



## II. FAKTET

4. Pas shqyrtimit të korrespondencës së dorëzuar nga ankuesi, si dhe të parashtrimeve të Prokurorit të Specializuar, faktet mund të përmbliken si vijon.
5. Më 11 nëntor 2022, ankuesi u intervistua nga dy punonjës të ZPS-së.
6. Në fillim të intervistës, njëri prej punonjësve, gjatë leximit të një dokumenti, iu referua Republikës së Kosovës me fjalët ‘Kosovo i Metohija’ (‘Kosovë dhe Metohi’).
7. Në atë moment, ankuesi nuk ngriti ndonjë kundërshtim dhe shqetësim në lidhje me përdorimin e shprehjes ‘Kosovë dhe Metohi’, pasi u këshillua të mos e bënte këtë nga mbrojtësi i tij. Megjithatë, në fund të intervistës, ai shprehu shqetësimin e tij për përdorimin e kësaj shprehjeje në dokumentacion.

# SKANDALOZE: SPECIALJA I REFEROHET KOSOVËS ‘KOSOVO I METOHIJA’, REAGIME TË ASHPRA NË PRISHTINË

Dhomat e Specializuara të Kosovës në një dokument kanë përdorur termin “Kosovo i Metohija”. Kjo ka ngjallur reagime të ashpra në Kosovë nga avokatët, deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe përfaqësuesit e partive politike. Avokati Ardian Bajraktari ka theksuar se fakti se procesi gjyqësor në Dhomat e Specializuara ishte i manipuluar me “prova” nga shteti serb ka qenë diçka që e është thënë në vazhdimësi. Ndërkaq deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë thënë se ky veprim i Speciales është një akt i qëllimshëm, i motivuar politikisht, që përbën jo vetëm një fyerje të rëndë për qytetarët e Republikës së Kosovës, por edhe sfidim i institucioneve dhe shtetit tonë

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 10 PRILL (ER)** - Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës ka pranuar një ankesë nga një i intervistuar i Gjykatës Speciale në Hagë se gjatë intervistimit nga dy punonjës të ZPS-së i ishin referuar Kosovës “Kosova dhe Metohi”. Siç bëhet me dije në ankesën drejtuar Avokatit të Popullit të ZPS-së, më 11 nëntor të viti 2022, ankuesi u intervistuar nga dy punonjës të ZPS-së dhe në fillim të intervistës njëri prej punonjësve gjatë leximit të një dokumenti, iu referua Republikës së Kosovës me fjalët “Kosovo i Metohija”. “Më 11 nëntor 2022, ankuesi u intervistua nga dy punonjës të ZPS-së. Në fillim të intervistës, njëri prej punonjësve, gjatë leximit të një dokumenti, iu

referua Republikës së Kosovës me fjalët ‘Kosovo i Metohija’ (‘Kosovë dhe Metohi’). Në atë moment, ankuesi nuk ngriti ndonjë kundërshtim dhe shqetësim në lidhje me përdorimin e shprehjes ‘Kosovë dhe Metohi’, pasi u këshillua të mos e bënte këtë nga mbrojtësi i tij. Megjithatë, në fund të intervistës, ai shprehu shqetësimin e tij për përdorimin e kësaj shprehjeje në dokumentacion”, thuhet në ankesën e të intervistuarit drejtuar Avokatit të Popullit. Kjo ka ngjallur reagime të ashpra në Kosovë nga avokatët, deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe përfaqësuesit e partive politike. Avokati Ardian Bajraktari ka ngritur sërish akuza të rënda ndaj Dhomave të Specializuara, duke deklaruar se posedon fakte që dëshmojnë manipulimin e procesit gjyqësor me “prova” të ofruara nga shteti serb.

Sipas tij, kjo është një çështje që është theksuar vazhdimisht nga ai dhe të tjerë, por tashmë po del në sipërfaqe me të dhëna të reja që, siç thotë, vërtetojnë pretendimet e bëra më herët. “Këto fakte po dalin sheshazi gjithnjë e më shumë, në mesin e të cilave dëshmohej me ‘dokumente’ të kësaj gjykate ku i referohet Kosovës, ashtu siç i referohet vetëm Serbia. Faktet janë tashmë të qarta, ka shumë të tilla! Fakti se procesi gjyqësor në Dhomat e Specializuara ishte i manipuluar me ‘prova’ nga shteti serb ka qenë diçka që e kemi thënë në vazhdimësi. Manipulimi dhe mungesa e profesionalizmit kanë një emërues të përbashkët, gjejeni”, ka shkruar avokati Bajraktari në një postim në “Facebook”, të cilit i ka bashkëngjitur edhe disa dokumente që ai i konsideron dëshmi të qarta të këtij manipulimi. Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, Artan Behrami, ka thënë se Prokurorisë së Gjykatës Speciale nuk i ka mjaftuar që është shërbyer me dezinformata, dokumente të falsifikuara dhe dëshmi të rreme nga Serbia. “Nuk i ka mjaftuar që aty s’ka flamur, s’ka emblemë, s’ka shenja të shtetit të Kosovës. E paska rikthyer kohën e Millosheviqit, duke ringjallur frazën fashiste, ‘Kosova dhe Metohija’. Duket se aty punojnë dy lloje të njerëzve: burokratë ndërkombëtarë që udhëhiqen nga mendësia e Serbisë dhe, ndoshta, zyrtarë të shtetit serb të punësuar si burokratë!”, ka thënë Behrami. Në një përgjigje, siç kanë raportuar mediet në Prishtinë,

Zyra e Prokurorit të Specializuar e kishte pranuar se përdorimi i terminologjisë “Kosova dhe Metohija” ishte përdorur gabim gjatë intervistimit dhe se kanë thënë se kjo terminologji nuk është pjesë e praktikës së Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Sekretarja e Përgjithshme e PDK-së, deputetja Vlora Çitaku, ka theksuar se përdorimi i termit “Kosova dhe Metohija” nga ana e Prokurorisë së Gjykatës Speciale nuk është lapsus dhe as gabim i rastësishëm. “Është një akt i qëllimshëm, i motivuar politikisht, që përbën jo vetëm një fyerje të rëndë për qytetarët e Republikës së Kosovës, por edhe sfidim i institucioneve dhe shtetit tonë. Ky është një poshtërim. Testim i dinjitetit tonë si shoqëri, institucione, si shtet. Të gjitha institucionet e Kosovës duhet reaguar urgjentisht dhe seriozisht. Heshtja sot është aprovim nesër. Dhe nëse heshtim tani, historia nuk do të na falë”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”. Më 3 prill gjatë një konference për media në Prishtinë, zëdhënësit e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë raportuan mbi zhvillimet e procesit ndaj ish krerëve të UÇK-së. Ata informuan se Prokuroria ka përfunduar zyrtarisht prezantimin e provave në gjykatë, por nuk e ka mbyllur ende rastin, pasi seanca e ardhshme është caktuar për 23 prill. Zëdhënësjë e Gjykatës Speciale, Angela Griep, ka thënë se në gjykatë kanë dëshmuar 125 dëshmitarë, kurse 117 me shkrim. “Nga ajo që dimë është

se Prokuroria ka konfirmuar se kanë përfunduar me prezantimin e provave, por nuk e kanë mbyllur rastin zyrtarisht. Seanca e radhës është caktuar më 23 prill. Prokuroria deri atëherë do ta përfundojë rastin...125 dëshmitarë kanë qenë, dhe 117 kanë dëshmuar vetëm me shkrim. 206 ditë të gjykimit, dhe 150 viktima”, ka thënë Griep. Ajo shtoi se gjyqtarët e Dhomave të Specializuara sigurojnë një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, duke nënvizuar se ata janë të angazhuar për të zbatuar një kod etik. Ndërsa, zëdhënësi tjetër, Michael Doyle, u shpreh se qytetarët e Kosovës duhet të besojnë se Specialja sjell vendime të drejta, dhe se vendimi i gjyqtarëve bazohet vetëm në prova. Ai gjithashtu theksoi se është e rëndësishme që viktimat dhe dëshmitarët të mund të japin dëshmi në një mjedis të sigurt dhe të dinjitetshëm. Gjykata Speciale është themeluar në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por vepron me personel ndërkombëtar në Hagë. Kjo gjykatë heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të UÇK-së, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë, nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Gjykata Speciale, deri më tani, ka shpallur dy aktgjykime për krime lufte, ndaj Salih Mustafës dhe Pjetër Shalës, dhe dy tjera për pengim të administrimit të drejtësisë, ndaj Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucatit.

# ‘KAM FRIKË PËR TË ARDHMEN E FËMIJËVE’, KOSOVA PRIN NË RAJON ME NIVELIN E METANIT NË AJËR



**PRISHTINË, 10 PRILL** - Në të kaluarën i hapte dritaret çdo mëngjes për ta ajrosur shtëpinë. Por, Izet Grajgevcit, 53-vjeçarit nga Obiliqi, një gjë e tillë vetëm se do t’ia vështirësonte qëndrimin në shtëpinë e tij, sidomos gjatë stinës së dimrit. Kjo për shkak të ajrit të ndotur dhe smogut të dendur. Me bashkëshorten dhe dy vajzat e tij, ai jeton në një banesë afër termocentraleve të Korporatës Energetike të Kosovës (KEK) në Obiliq, ku cilësia e ajrit është e ulët për shkak të ndotjes nga termocentralet dhe deponive të mbeturinave që ndodhen afër shtëpisë së tij. Realiteti me të cilin po përballet çdo ditë brengos Izraelin për të ardhmen e familjes së tij. “Shqetësohem për dy vajzat që duhet të rriten këtu, në këtë ajër të ndotur. Erën e tij të keqe e nuhasim edhe kur i thajmë rrobat. Nëse do të kisha mundësi, sonte do të shpërngulesha diku”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë, duke shtuar se opsion janë edhe qytetet në pjesën perëndimore të Kosovës, larg termocentraleve të KEK-ut. Ai thotë se vuan pasojat nga ajri i ndotur tash e 12 vjet. “Shpesh ndihem i lodhur dhe me plogështi, kjo ka filluar që nga viti 2013. Kam pasur edhe probleme me frymëmarrje. Kur kam qenë në Qendrën Komunale të Mjekësisë Familjare më kanë thënë të kujdesem që të mos dal jashtë shumë, sidomos gjatë orëve të mbrëmjes”, thekson ai. Kështu, për t’iu shmangur ajrit të ndotur, ai mban dritaret e shtëpisë të mbyllura dhe nuk del nga shtëpia kur nuk e ka të domosdoshme. Problemi i ajrit të ndotur prek

një numër të madh të qytetarëve në Kosovë, sidomos në zonat urbane, ku statistikatat tregojnë për nivele të larta të gazrave të dëmshme në ajër. Matjet e Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës shpërfaqin nivele të larta të substancave të rrezikshme për shëndetin, siç është dyoksidi i karbonit, monoksidi dhe gazrat serrë. E krahas këtyre ndotësve, në Kosovë ekziston një tjetër armik i fshehtë e kërcënues për shëndetin publik, e që është metani. Ky gaz, i padukshëm dhe pa erë, lirohet nga deponitë e mbeturinave, termocentraleve dhe burimet e tjera ndotëse. Kështu thuhet në të dhënat e raportit të fundit të Bankës Botërore për ndryshimet klimatike në Ballkanin Perëndimor, ku Kosova renditet e para në rajon për nivelin më të lartë të metanit në ajër, për kokë banori në zonat urbane.

## Pse Kosova po prin me nivelin e metanit në ajër?

Profesori për Edukim Mjedisor, Zeqir Veselaj, thotë se arsyet kryesore pse Kosova po prin në Ballkanin Perëndimor në këtë drejtim, janë keqmenaxhimi me deponitë e mbeturinave, zjarret në pyje, përdorimi i thëngjillit për ngrohje dhe termocentralet e Obiliqit. Ai shton se një faktor tjetër shqetësues është edhe numri i madh i veturave të vjetra që qarkullojnë në Kosovë. “Ndikim në ndotjen e ajrit ambiental urban ka edhe sektori i transportit, me afërsisht gjysmë milioni vetura e makineri në rrugët e Kosovës”, thekson ai për Radion Evropa e Lirë. Ndërkaq, nga institucioni që bën

monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë, Instituti Hidrometeorologjik (IHMK), thonë se nuk kanë të dhëna për gjendjen aktuale. “Ne nuk disponojmë të dhëna nga monitorimi, pasi deri më tani nuk kemi kryer matje për metanin”, thonë nga IHMK-ja. Megjithatë, nga ky institut shtojnë se, bazuar në përvojën e tyre, burime kryesore të metanit janë minierat e vjetra të qymyrit dhe deponitë e mbeturinave. Për deponitë e mbeturinave shpreh shqetësim edhe profesori Zeqiraj. “Dyoksidi i karbonit dhe metani përbëjnë rreth 90 për qind të gazrave që lirohen. Por, nga deponitë lirohen edhe gazra të tjera, si amoniak, sulfide, substanca azotike, hidrogjen etj, me pasoja për shëndetin publik të rrethinave”, thotë ai. Kërkesës së Radios Evropa e Lirë për informacione rreth kësaj teme nuk i është përgjigjur Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit. Mirëpo, sipas Inventarit të Gazeve Serrë për Kosovën, të publikuar nga ta gjatë vitit të kaluar, thuhet se 86 për qind e emetimeve të gazrave serrë, përfshirë metanin, vijnë nga sektori energjetik, ndërsa pjesa e mbetur nga bujqësia, mbeturinat dhe industria. Radio Evropa e Lirë ka pyetur KEK-un për lirimin e gazrave serrë nga termocentralet e tij dhe strategjitë e ardhshme për përmirësim, por s’ka marrë përgjigje.

## Si ndikon metani në shëndet?

Nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) thonë se efektet e

metanit në shëndet mund të jenë mjaft serioze dhe jo vetëm në frymëmarrje. “Mund të kemi ndryshime të humorit, të folur të paqartë, probleme me shikimin, humbje të kujtesës, të përziera, të vjella, skuqje të fytyrës dhe dhimbje koke”, thuhet në përgjigjen e IKSHPK-së dërguar Radios Evropa e Lirë. E, në zonat ku qytetarët kanë më shumë kontakt me metanin në ajër, nga IKSHPK-ja thonë se ndikimi mund të jetë edhe më i rëndë. “Mund të shkaktojë ndryshime në frymëmarrje, përkeqëson sëmundjet e mushkërive, shkakton sulme astmatike dhe rrahje të zemrës, sëmundje kardiovaskulare dhe vdekshmëri si dhe rrit rrezikun e goditjes në tru, probleme të ekuilibrit, mpirje dhe pavetëdije”, thonë nga IKSHPK-ja. Bazuar në raportin për ndotje të ajrit të këtij institucioni, në Kosovë ka pasur rritje të pacientëve me sëmundje të frymëmarrjes gjatë vitit të kaluar. Rreth 6.500 vizita për probleme të tilla u kryen në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, prej të cilëve 3.244 ishin fëmijë. Organizata Botërore e Shëndetësisë e cilëson metanin si gazin kryesor që ndikon në ndryshimet klimatike dhe ndër shkaktarët kryesorë të problemeve me frymëmarrje e të shëndetit kardiovaskular.

## Cila është zgjidhja për përmirësimin e gjendjes?

Sipas profesorit Veselaj, prioritet duhet të jetë trajtimi i deponive ilegale të mbeturinave. “Afërsisht gjysma e mbeturinave që përfundojnë në deponitë e Kosovës janë mbeturina organike [si mbetjet ushqimore], që

njëkohësisht janë edhe burim i metanit. Duhet promovuar praktikat e ndarjes apo riciklimit të mbetjeve”, thotë ai, duke shtuar se kjo do të ndikonte në nivel më të ulët të mbetjeve organike nëpër deponi, e rrjedhimisht nivel më të ulët të metanit në ajër. Edhe IKSHPK-ja ka disa kërkesa urgjente për menaxhimin e burimeve të metanit në ajër. “Urgjentisht të merren masa rigorozë të kontrollit teknik të automjeteve, mirëmbajtja e rrugëve, menaxhimi i drejtë i mbeturinave të ngurta, monitorimi transparent dhe i vazhdueshëm i filtrave të termocentraleve”, thonë nga IKSHPK-ja. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës e Kosovës nuk i është përgjigjur pyetjeve të REL-it lidhur me këtë temë. Gjatë fushatës zgjedhore të sivjetme, para zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, gjendja e mjedisit nuk ishte pikë kyç e diskutimit. Partitë që garuan nuk paraqitën plane të detajuara se si do t’i adresonin këto probleme. Ndërkaq, në shtetet e Bashkimit Evropian, aty ku Kosova synon që një ditë të anëtarësohet, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të menaxhuar ndotjen nga metani. Për shembull, Gjermania ka zbatuar teknologji të avancuara për përpunimin e mbetjeve organike dhe riciklimin e tyre, duke reduktuar nivelin e metanit në ajër. Shumica e shteteve të BE-së kanë investuar edhe në burime alternative për prodhimin e energjisë si ajo diellore, dhe mospërdorimin e thëngjillit në termocentrale.

## Kurti e Rohde flasin për heqjen e masave të BE-së ndaj Kosovës

**PRISHTINË, 10 PRILL** - Kryeministri në detyrë Albin Kurti ka takuar ambasadorin e Gjermanisë në Prishtinë Jorn Rohde. Siç njofton Zyra e Kryeministrit, gjatë takimit u diskutua mbi zhvillimet për formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve të 9 shkurtit, sundimin e ligjit dhe heqjen e masave ndëshkuese evropiane. Kurti teksa uroi Rohde për përfundimin e suksesshëm të procesit të formimit të koalicionit qeverisës në Gjermani pas zgjedhjeve të 23 shkurtit, përsëriti nevojën për heqjen e masave ndëshkuese që

BE-ja ka vendosur ndaj Kosovës më 2023 për shkak të përshkallëzimit të situatës së sigurisë në veri. Komisioni Evropian ka akuzuar Qeverinë Kurti për veprime të pakoordinuara me gjithë thirrjet e komunitetit ndërkombëtar. Masat ndëshkuese në qershor 2023 përfshijnë suspendimin e përkohshëm të grupeve punuese për Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit, suspendimin nga programi i fondeve për Kosovën, mos ftesën e Kosovës në takime të nivelit të lartë përveç takimeve në dialogun me Serbinë dhe

mosmiratimin e projekteve nga Fondi për Investime në Ballkanin Perëndimor. Parlamenti Evropian ka kërkuar heqjen e masave ndëshkuese ndaj Kosovës, duke thënë se ato janë në kontradiktë me përkushtimin e dëshmuar të Kosovës ndaj vlerave evropiane dhe me përshtatjen e saj me politikën e BE-së. Shefi i Zyrës së BE-së në Prishtinë, Aivo Orav, ka kujtuar se për heqjen e masave, nevojitet konsensusi i 27 shteteve të BE-së, dhe ka thënë se diskutimet për këtë çështje janë në proces e sipër.



# MEDALJA PRESIDENCIALE NGA IZRAELI - ÇMIM PËR GJITHË KOMBIN SHQIPTAR



### Lulëzim ETEMAJ

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është nderuar më 7 prill 2025 nga presidenti i Izraelit, Isaac Herzog, me Medaljen Presidenciale të Nderit, urdhri më i lartë civil i Izraelit. Ky çmim u ndahet personaliteve të rëndësishme botërore në politikë, dhe në këtë rast vjen si nderim për besën tonë shqiptare, shembullin që kombi ynë i dha botës duke mos e dorëzuar asnjë hebre, si dhe tolerancën tonë fetare dhe etnike

të dëshmuar ndër shekuj. “Nder i madh t’u uroj mirëseardhjen në rezidencën presidenciale dhe t’u jap medalje presidenciale të nderit të Izraelit, urdhri më i lartë civil i Izraelit. Kjo medalje nderon ata si ju që kanë ndriçuar botën me udhëheqje të jashtëzakonshme, që kanë dëshmuar miqësinë e guximshme me popullin hebre. Kodi shqiptar i besës, betimi i shenjtë i nderit, mbrojtjes dhe integritet ndihet në këtë holl. Besa ka udhëhequr kombin shqiptar, gjatë Holokaustit, shqiptarët ishin simbol nderi

dhe kurajo që u dhanë strehë hebrenjve që arratiseshin nga pjesë të tjera të Evropës. Kjo thirrje integriteti e nderi e popullit tuaj gjen jehonë fort në udhëheqjen tuaj”, ka thënë me këtë rast presidenti Isaac Herzog. “Ky nder i jashtëzakonshëm nuk mund të jetë vetëm për mua, por e marr në emër të Shqipërisë, popullit shqiptar, në emër të gjithë shqiptarëve myslimanë e krishterë që vendosën jetën në rrezik gjatë orëve më të errëta të historisë dhe e kthyen vendin tim, në të vetmin vend në Evropë që e mbylli Luftën e Dytë

Botërore me më shumë hebrenj se sa në fillim të saj”, tha kryeministri Rama. Sipas të dhënave historike, shqiptarët shpëtuan së paku 3280 hebrenj gjatë kohës së Holokaustit. Në periudhën kohore 1933-1944, Shqipëria i strehoi, i mori në mbrojtje dhe i shpëtoi jo vetëm hebrenjtë vendas, por edhe të gjithë ata që pa u penguar nga autoritet e saj ia arritën të hynin në Shqipëri nga vendet e ndryshme të Evropës. Gjurmët e shpëtimit të tyre gjenden në qytetet e fshatrat e

Mitrovicës, Prishtinës, Gjilanit, Deçanit, Pejës, Gjakovës, Shkodrës, Krujës, Tiranës, Beratit, Kavajës, Durrësit, Elbasanit, Librazhdit, Korçës, Dibrës, Burrelit, Fierit, Lushnjës, Vlorës, Delvinës, Përmetit, Gjinokastrës, etj. Ky çmim na e jep edhe një arsye më shumë të jemi krenar për vlerat tona, si besa, mikpritja, toleranca fetare dhe etnike, marrja në mbrojtje e njerëzve të shtypur dhe të ndjekur, me çka japim kontributin tonë të fuqishëm në pasurimin e vlerave universale të njerëzimit.

## Në QKUK kryhet një operacion shumë i rrallë

**PRISHTINË, 10 PRILL** - Në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës, për herë të parë në Kosovë është kryer një operacion shumë i rrallë, Bypass aorto-bifemoral, me graft vaskular “Dacron”. Në këtë rast aorta e barkut, e cila ishte e mbyllur në pjesën e poshtme të saj, ishte e shoqëruar jo zakonisht me venën e barkut të dyfishtë [duplicated inferior vena cava (DIVC)], një anomali shumë e rrallë 0.05% të rasteve. Intervenimi ka zgjatuar më shumë se 5 orë, të një pacient i moshës 48 vjeç. Pacienti përveç mbylljes të segmentit të poshtëm të enës kryesore të gjakut (aorta abdominalis), nga sëmundja aterosklerotike, për çka kishte kërkuar ndihmën mjekësore,

kishte edhe një anomali, me ç’rast aorta e barkut ndodhej në mesin e venës kava inferior të dyfishtë, (doubly vena cava inferior). Të vetëdijshëm se bëhej fjalë për një rrezik operativ të konsiderueshëm, ekipi mjekësor në përbërje: prof. ass. dr. Lulzim Vokri, dr. Hajriz Rudari, dr. Ramë Gashani, dr. Albion Haxhijaha dhe Antigona instrumentare si dhe anestezioni; dr. Flora Marashi - anestezilog dhe reanimator, Mirja teknike vendosi që pacienti t’i nënshtrohet intervenimit kirurgjik, në kushte të anestezionit gjeneral. Për të arritur deri te aorta abdominale dhe vena cava inferior e dyfishtë, përparimi ishte shumë i vështirë, për shkak të pozitës jo normale të këtyre dy

enëve të mëdha të gjakut dhe obezitetit të pacientit. Pas punës disa orëshe, mjekët realizojnë Bypassin (urëzimin) prej një pjese të shëndoshë të aortës së barkut, nën veshka, deri në dy arteriet kryesore të këmbëve (arteria femoris communis). Për këtë qëllim u përdor grafti vaskular sintetik Dacron në formë “Y” me dimensione 18/9mm. Për më tepër, rastet e tilla janë raportuar shumë rrallë në literaturën mjekësore. Pas operacionit janë kryer ekzaminimet kontrolluese, ku është konstatuar se intervenimi kirurgjik ishte kryer me sukses të plotë dhe pacienti pas 10 ditë hospitalizimi, lëshohet në shtëpi në gjendje shumë të mirë shëndetësore.



# ROLI I SINJALIZUESVE, MJET I FUQISHËM PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

**PRISHTINË, 10 PRILL** - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), në bashkëpunim me Koalicionin e Evropës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, organizuar Konferencën rajonale për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe Takimin vjetor të koalicionit, me fokus në rolin e reformës në drejtësi si një faktor kyç për forcimin e sundimit të ligjit. Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv i IKD-së, tha se sinjalizimi përbën një mekanizëm efektiv për luftimin e korrupsionit dhe përmirësimin e qeverisjes, duke ndihmuar gjithashtu në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore. “Të gjendur brenda institucioneve publike, zyrtarët publikë kanë informata të shumta për keqgjëra dhe shkelje në

institucione publike. Sinjalizimi si mjet i fuqishëm për parandalimin e korrupsionit, për ngritjen e integritetit të institucioneve na mundëson që përmes këtij mekanizmi të luftojmë, jo vetëm korrupsionin, por ta bëjmë edhe qeverisjen më të mirë, duke e kthyer edhe besimin e publikut- qytetarëve në institucioneve publike”, tha ai. Ish-kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, Gresa Caka-Nimani, vlerësoi rolin e sinjalizuesve si mishërim i guximit qytetar, duke theksuar se demokracia kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe të ndërtuar mbi të vërtetën. “Çdo diskutim për këtë temë duhet të fillojë me pranimin e qartë të faktit se sinjalizuesit përfaqësojnë mishërimin e

guximit në një botë që shpesh preferon heshtjen para llogaridhënies. Përmes veprimeve të tyre ata na kujtojnë se demokracia nuk është trashëgimi pasive, por përgjegjësi dinamike, e ndërtuar mbi të vërtetën, guximin për të folur hapur dhe vënien e besimit në vlera dhe ideale për të mirën publike përpara interesave personale, me vetëdije të plotë për pasojat që mund të sjellë kjo zgjedhje. Kështu, guximi i tyre frymëzon”, tha Caka-Nimani. Jarmo Helppikangas, përfaqësues i Zyrës së BE-së në Kosovë, bëri të ditur se është shënuar një rritje prej 30 për qind e rasteve të sinjalizimit, krahasuar me një vit më parë, duke nënvizuar nevojën për zbatim të plotë të ligjeve për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe për

krijimin e një ambienti të sigurt për ta. “Kemi rritje të sinjalizuesve 30 për qind me periudhën me vitin e kaluar dhe ky është vetëm një element që këto dispozita të zbatohen si duhet. Ky sistem duhet të jetë i besueshëm dhe ata nuk duhet të jenë objekt i ndonjë hakmarrjeje”, tha Helppikangas. Arjan Dyrmishi, drejtor ekzekutiv i Qendrës për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG), tha se pavarësisht nga përparimet ligjore, korrupsioni mbetet një sfidë serioze në rajon, me pasoja të drejtpërdrejta për qytetarët. “Pavarësisht nga zhvillimet pozitive në fushën e legjislacionit, krijimit të sistemeve për marrjen e hetimeve të sinjalizuesve, akoma mbetet shumë për t’u bërë. Korrupsioni vazhdon të mbetet

një sfidë e madhe në shtetet e Evropës Juglindore, në të cilat është më i lartë se në vendet e tjera të Evropës. Ngjarjet tragjike të fundit në Novi Sad, por edhe në Maqedoninë e Veriut, kanë treguar se korrupsioni po u kushton qytetarëve, jo vetëm dëme ekonomike, por edhe humbje të jetëve të shumë qytetarëve”, tha ai. Ndërsa, Nikola Naumovski nga Iniciativa Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI), tha se vendet e Ballkanit kanë përafruar legjislacionin e tyre me standardet e BE-së, përfshirë edhe fushën e sinjalizimit. “Kur ka korrupsion, ka lëngim të sundimit të ligjit dhe për këtë shoqëritë e Ballkanit dhe Evropës Juglindore kanë trajtuar këtë luftë si prioritet edhe për integrimin në Bashkimin Evropian”, tha ai.



# PDK-ja PRET DELEGACIONIN NGA MBRETËRIA E BASHKUAR, ÇITAKU I FALËNDERON PËR MBËSHTETJEN E VAZHДУESHME NDAJ KOSOVËS



**PRISHTINË, 10 PRILL** - Sekretarja e Përgjithshme e Partisë Demokratike të Kosovës, Vlora Çitaku, ka pritur të enjten një delegacion nga Mbretëria e Bashkuar, të përbërë nga deputeti britanik Alex Sobel dhe anëtarja e “City Leaders”, Cllr Helen Hayden. Në takim, Çitaku ishte e shoqëruar nga Kryetarja e Rinisë Demokratike dhe deputetja e sapozgjedhur, Arbnora Salihu, si dhe shefi i kabinetit të Kryetarit Memli Krasniqi, Ardian Arifaj. Gjatë diskutimit u vlerësua lart miqësia dhe partneriteti

ndërmjet Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, me theks të veçantë tek bashkëpunimi politik, ndihma institucionale dhe mbështetja për rininë dhe fuqizimin e grave në politikë. Çitaku shprehu mirënjohjen e saj për kontributin e vazhdueshëm të Mbretërisë së Bashkuar në ndërtimin e institucioneve demokratike në Kosovë. “Jemi thellësisht mirënjohës për partneritetin e fortë me Mbretërinë e Bashkuar. Mbështetja e tyre ka qenë jetike në rrugëtimin tonë drejt forcimit të shtetit ligjor dhe

zhvillimit demokratik. Takime si ky na japin mundësinë të thellojmë bashkëpunimin dhe të ndërtojmë ura të reja miqësie e mirëkuptimi”, tha Çitaku. Delegacioni britanik u interesua për zhvillimet aktuale politike në vend, sfidat e rinisë dhe fuqizimin e grave në institucionet vendimmarrëse, duke shprehur gatishmërinë për bashkëpunim të mëtejshëm. Partia Demokratike e Kosovës mbetet e përkushtuar ndaj thellimit të raporteve ndërkombëtare dhe forcimit të lidhjeve me aleatët strategjikë të Kosovës.

## Deçani nderon me titull “Qytetar Nderi” gjeneralin amerikan Arthur Garffer

**DEÇAN, 8 PRILL** - Komuna e Deçanit ka nderuar me titullin “Qytetar Nderi” gjeneralin amerikan Arthur Garffer. “Deçani nderoi një

mik të madh të Kosovës, Gjeneralin amerikan Arthur Garffer, me titullin ‘Qytetar Nderi’. Ky vlerësim buron nga zemrat e njerëzve të Deçanit

dhe i dedikohet jo vetëm kontributit personal të Gjeneral Garffer, por edhe secilit ushtar amerikan që ka dhënë kontribut për lirinë e

popullit tonë dhe sot shërbejnë me përkushtim për paqe e siguri në Kosovë”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.



# Bizneset zëshëm kundër shtrenjtimit të rrymës

**PRISHTINË, 10 PRILL** - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka shprehur shqetësimin për paralajmërimin për shtrenjtimin e energjisë elektrike 15 për qind.

Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, në një intervistë për “Ekonomia Online” ka theksuar se shtrenjtimi i rrymës do të ndikojë negativisht te bizneset dhe qytetarët, duke i shtuar vështirësitë ekonomike dhe varfërinë.

Ai vuri në dukje se mbi 1 300 biznese, përfshirë ato me mbi 50 punëtorë, do të detyrohen të blejnë energji elektrike në tregun e hapur, që do të çojë në shtrenjtimin e produkteve dhe shërbimeve. “Ngritja e çmimit të energjisë dhe paralajmërimet e saj për ngritje për 15% është një goditje për bizneset dhe qytetarët. Kjo do të varfërojë edhe më tutje shportën konsumuese të qytetarëve të vendit, por edhe të bizneseve që do të detyrohen të shtrenjtojnë shërbimet e veta, sidomos kur të hyjë në fuqi blerja e energjisë nga 1 qershori në tregun e hapur. Mbi 1300 biznese do të detyrohen të blejnë energji elektrike. Kjo i detyron të gjitha bizneset që kanë më shumë se 50

punëtorë. Ne e vlerësojmë se kjo është një ngarkesë për bizneset dhe prodhuesit dhe në anën tjetër do t'i faturohet konsumatorit”, tha Shahini.

Ai kërkoi nga institucionet shtetërore që të mbajnë tarifat aktuale të energjisë elektrike për të shmangur pasojat e rritjes së çmimit. “Nëse bizneset detyrohen ta blejnë energjinë, ato do të duhet të shtrenjtojnë produktet, për shkak të rritjes së çmimit të energjisë elektrike. Ende bizneset nuk e kanë mundësinë për të blerë energji kaq të shtrenjtë, kur kemi KEK-un, ku nuk u lejohej bizneseve vendore të blejnë energjinë elektrike. Vetë ngritja e çmimit do të ndikojë në rritjen e varfërisë në Kosovë. Kërkesa jonë ndaj institucioneve shtetërore është që të vazhdojnë me tarifat e mëparshme, në mënyrë që të tejkalohen këto vështirësi” shtoi kryetari.

Shahini gjithashtu vuri në dukje se rritja e çmimit të energjisë do të ketë pasojë të mëdha në konsum dhe zhvillimin ekonomik të vendit. “Sipas standardeve të Bankës Botërore, që bëjnë hulumtime në të gjitha vendet, nëse



energji elektrike në një shtet rritet për 10 për qind tërë konsumi në atë shtet rritet nga 1.5 deri 2 për qind. Nëse rritet. Nëse rritet si rasti i Kosovës për shembull 15-20 për qind, atëherë gjithçka rritet në ekonominë e Kosovës 4-5% për qind. Kosova dhe konsumatorët me këto paga nuk do të mund të përballojnë këtë rritje të çmimit të energjisë elektrike”, ka thënë

Shahini. Kryetari i AKB-së tha se edhe protestat duhet të japin një mesazh të qartë që të mos ngritët çmimi i energjisë elektrike. “Tregu i hapur duhet të jetë i barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë, sepse ne kemi më shumë se 19 operatorë. Mbi 90 për qind është një operator ekonomik që furnizon gjithë tregun me

energji. Ende nuk dihet se si do të përdoret infrastruktura energjetike për bizneset, që do të detyrohen të blejnë energji jashtë shtetit dhe çfarë kostoje do të ketë kjo”, ka thënë Shahini.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka njoftuar se vendimi për çmimin e energjisë elektrike do të merret më 11 prill.

## BERZH-i dhe BE-ja prezantojnë programin prej 377 milionë euro për digjitalizimin e NVM-ve në Ballkanin Perëndimor



**PRISHTINË, 10 PRILL** - Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) në të gjithë Ballkanin Perëndimor do të përfitojnë nga mundësi të reja financimi përmes programit “Go Digital in the Western Balkans”, i cili kombinon kredi, grante dhe asistencë teknike për investime në digjitalizim, automatizim dhe teknologji të gjelbra.

Programi, i zhvilluar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) me mbështetjen e Bashkimit Evropian (BE), synon të nxisë inovacionin, konkurren-

eshmërinë dhe rritjen e qëndrueshme të sektorit privat në Ballkanin Perëndimor. Në kuadër të programit, BERZH-i do të akordojë deri në 350 milionë euro për institucionet financiare partnere në rajon, të cilat do të i ri-japin këto fonde përmes kredive për NVM-të. Përfituesit do të kenë gjithashtu në dispozicion grante stimuluese në masën 10 për qind të shumës së kredisë, të financuara nga BE. Në total, BE po ofron 27.6 milionë euro në forma grantesh stimuluese dhe asistencë teknike për këtë

program, të siguruar përmes Kornizës së Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF). Programi ndërtohet mbi suksesin e programit pilot “Go Digital në Bosnjë dhe Hercegovinë”, i cili mbështeti investimet e rreth 200 kompanive vendore. Event i prezantimit u ndoq nga përfaqësues të institucioneve financiare partnere dhe sektorit të biznesit nga rajoni, dhe shënon një hap të rëndësishëm drejt forcimit të qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së sektorit privat në Ballkanin Perëndimor.

## Bulliqi e Durmishi nënshkruajnë memorandum për projekte infrastrukturore në vlerë prej rreth 5 milionë eurosh

**PODUJEVË, 10 PRILL** - Kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimin me zëvendësministrin e infrastrukturës Hysen Durmishi për financimin e 5 projekteve të mëdha infrastrukturore në vlerë prej afër 5 milionë eurosh në Podujevë.

Projektet që do të financohen me këtë marrëveshje janë: Rikonstruimi dhe asfaltimi i rrugëve në qytet: “Bahri Fazliu”, “Agron Rrahmani”, “Ali Ajeti”, “19 Qershori” dhe “Bedri Bajrami”, me gjatësi

totale prej 1,770 metrash, si dhe ndërtimi i urës mbi lumin Llap, rrugë lidhëse me rrugën nacionale N25 - Podujevë, me vlerë prej 1,434,000 euro. Ndërtimi i rrugës Orllan-Rakinicë dhe rrugës “Rubiku” në Orllan, me gjatësi 5,030 metra, si dhe ndërtimi i trotuarit te ura në Orllan, me gjatësi 300 metra, me vlerë prej 983,400 euro. Ndërtimi i rrugëve lidhëse Llugë-Bellopojë dhe Siboc-Dumosh, me gjatësi 2,600 metra, në vlerë prej 531,500 euro. Ndërtimi i rrugëve në

fshatrat Sylevicë dhe Tërrenavicë, me gjatësi 6 kilometra, në vlerë prej 774,000 euro. Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Bajčinë, Dobërdol, Pakashticë, Metehi, Dumnicë, Bellopojë, Brainë, Tërrenavë, Llapashticë, Gllamnik, Sfeçël, Dumosh dhe rrethinë - Podujevë me vlerë prej 965,000 euro. Bulliqi falënderoi zëvendësministrin Durmishi për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme në projekte infrastrukturore për qytetarët llapjanë.



# HISTORIA E VËRTETË E ARRATISJES SË MADHE

Në një natë me dëborë dhe pa hënë në vitin 1944, mbi 200 oficerë aleatë tentuan të arratiseshin nga një kamp gjerman i të burgosurve të luftës. Ishte kulmi i një plani jashtëzakonisht ambicioz, i cili zgjati më shumë se një vit dhe përfshinte ryshfete, gërmime tunelesh dhe prodhimin në seri të pajisjeve, uniformave dhe dokumenteve – ku gjithçka duhej të fshihej me kujdes nga rojet dhe spiunët e kampit.

Arratisja e Madhe [The Great Escape], filmi i vitit 1963 i regjisorit John Sturges mbi këtë arratisje, është një klasik shumë i dashur, me aktorë si Steve McQueen,

Richard Attenborough dhe James Garner. Por, përmban shumë pasaktësi. Historiani dhe prezantuesi i podkastit Historia e kondensuar [Condensed History], Jem Duducu, në një intervistë për Metro e përshkroi si “një përzierje e çuditshme mes një rikrijimi të kujdesshëm dhe një fantazie të pastër holivudiane”. Historia u tregua për herë të parë nga Paul Brickhill, një nga pjesëmarrësit në përgatitjen e arratisjes, në librin e tij të vitit 1950, Arratisja e madhe [The Great Escape]. Ai përshkruan Ley Kenyonin, i cili ilustroi librin, si “falsifikuesin mjeshtëror” të misionit. Duke folur për filmin në një intervistë me Dilys Morganin në emisionin Nationwide të BBC-së në vitin 1977, Kenyon tha:

“Filmi ishte argëtues, por nuk e shprehte aspak tmerrin e vërtetë të të qenit i burgosur lufte – tmerrin, sigurisht, të ndjenjave personale nga të qenit prapa telave me gjemba: mërzia, uria. Uria ishte veçanërisht e rëndë”.

Të tjerë ish-të burgosur kishin një mendim ndryshe për filmin. Charles Clarke, i cili ndodhej në kamp në atë kohë dhe kishte ndihmuar në plan si vëzhgues, i tha BBC-së në një intervistë radiofonike në vitin 2019: “Edhe pas gjithë këtyre viteve, gjithmonë kam menduar se ishte një film i jashtëzakonshëm”.

Një ndryshim i madh që bëri filmi ishte në personazhet e përfshira. Edhe pse ngjarjet e Arratisjes së Madhe janë kryesisht të bazuara në fakte reale, emrat u ndryshuan dhe disa njerëz u përshkruan si karaktere të përbëra nga disa individë. Në kohën e arratisjes, asnjë amerikan nuk ndodhej më në kampin kryesor, dhe njeriu që thuhet se ishte modeli për personazhin e Steve McQueenit, Virgil Hilt – William Ash – nuk mori pjesë. Plani u udhëhoq nga komandanti i skuadriljes Roger Bushell – i cili në film u quajt Bartlett dhe u interpretua nga Attenborough. Bushelli ishte kapur për herë të parë në vitin 1940, pasi u rrëzua me aeroplan dhe kishte një histori mbresëlënëse tentativash



arratisjeje – një herë arriti të afrohej vetëm 100 metra pranë kufirit me Zvicrën neutrale.

Stalag Luft III ishte përpjekja e gjermanëve për të ndërtuar një kamp të pamundur për arratisje, i dedikuar posaçërisht për oficerët e forcave ajrore nga Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Australia, Polonia dhe vende të tjera aleate. Ai u ndërtua dhe u administrua nga forcat ajrore [Luftwaffe] si një vend i sigurt për të mbajtur njerëzit që ata i konsideronin si kërcënim për arratisje. Ajo që nuk kishin marrë parasysh, megjithatë, ishte pasoja e mbledhjes së kaq shumë ekspertëve të arratisjes në një vend të vetëm.

Kampi ishte ndërtuar mbi një tokë ranore, e cila ishte shumë e vështirë për t’u gërmuar për të hapur tunel. Shtresa e poshtme ishte gjithashtu më e çelët dhe më e verdhë se shtresa sipërfaqësore e errët, gjë që e bënte të dukshme nëse dilte në sipërfaqen e kampit. Barakat ishin ngritur mbi këmbë tullash në mënyrë që të ishte më e lehtë të vërehej nëse po hapej ndonjë tunel poshtë tyre. Brickhilli përshkruan në librin e tij një “gardh të dyfishtë me tela me gjemba, nëntë këmbë (2.75 metra) i lartë”, dhe menjëherë jashtë tij, “kullat e rojeve” 15 këmbë (4.5 metra) të larta çdo 100 jardë (rreth 90 metra), të mbikëqyrura nga rojet e armatosura me reflektorë dhe mitraloza. Për më tepër, në tokë kishin vendosur mikrofonat për të kapur çdo tingull që vinte nga gërmimet.

Siç mund ta prisni nga një plan i hartuar nga ushtarakët, puna për gërmimin e tuneleve u zhvillua me efikasitet ushtarak. Bushelli – i njohur edhe si “Big X” – ishte në krye të operacionit dhe shpërndante detyra të ndryshme te pjesëtarët e tjerë. Planet nisën madje përpara se të ndërtohej Stalag Luft III: Bushelli dhe disa të tjerë e dinin që kampi po

bëhej, dhe u ofruan si vullnetarë për të ndihmuar në ndërtimin e tij. Kjo u dha mundësinë ta hartonin dhe të zgjidhnin pikat më të përshtatshme për hapjen e tuneleve. Bushelli pati idenë që të hapeshin jo një, por tri tunele njëkohësisht. Logjika ishte që nëse gjermanët do të zbulonin njërin, nuk do të dyshonin se ekzistonin edhe dy të tjerë. Ato do të përmendeshin vetëm me emrat e tyre të koduar: Tomi, Diku dhe Heri. Bushelli kërcënoi me gjyq ushtarak këdo që do të përmendte fjalën “tunel”.

Qëllimi ishte që të arratiseshin 200 burra. Ishte një ndërmarrje gjigante. Çdo burrë kishte nevojë për veshje civile, leje të falsifikuara, një busull, ushqim dhe pajisje të tjera. Disa leje kërkonin edhe fotografi, ndaj një aparat fotografik u fut në kamp nga një rojtar i korruptuar. Në film, personazhi Donald Pleasence është përgjegjës për falsifikimet. Në realitet, Kenyoni ishte një nga falsifikuesit që duhej të krijonte mijëra dokumente të rreme. Në intervistën për Nationwide, ai ka thënë: “Ndërtuam një shtypshkronjë, për një gjë, dhe çdo shkronjë duhej të gdhendej me dorë në gomën të cilën e merrnim nga këpucarët – nga thembrat e këpucëve – ose në copa druri që priteshin me brisk”. Çdo dokument duhej të ishte perfekt. Ata kopjonin dokumente që ose i kishin vjedhur nga rojet, ose kishin bindur rojet t’ua tregonin. “U prodhuan rreth 7-8 mijë copë dokumente”, tha ai.

Vetë tunelet ishin mrekulli inxhinierike dhe shpikëse. Një pompë ajri u ndërtua me çanta ushtarake dhe dru, dhe ajri kalonte përmes një tubi të bërë nga kanaçet e qumështit të dërguara nga Kryqi i Kuq. Një problem i madh ishte se ku do ta çonin gjithë atë rrërë të nxjerrë. Çanta të varura brenda pantallonave, të ndërtuara nga të

brendshmet e gjata, përdoreshin për të shpërndarë rrërën rreth kampit, ku më pas fshihej me shkëlma.

Nga tri tunelet, Tom u zbulua nga rojet pak para se të përfundonte. Pas një pushimi, u vendos që të vazhdohej vetëm me Herin. Ky tunel përfundoi në dimrin e vitit 1943 dhe u mbyll derisa të krijoheshin kushtet e duhura për arratisje. Ajo natë erdhi më 24 mars 1944. Shumë gjëra shkuan keq, por në fund, nga 220 personat e përzgjedhur, 76 arritën të dilnin përpara se i 77-ti të zbulohet nga një roje.

Një operacion masiv u organizua për të kapur 76 të arratisurit. Të gjithë e dinin se gjasat ishin që të kapeshin, por shumica e shihnin si detyrë përpjekjen për arratisje. Një tjetër synim i tyre ishte të detyronin gjermanët të tërhiqnin burimet nga përpjekjet luftarake, për të ruajtur dhe kërkuar të arratisurit. Sipas Brickhillit, pesë milionë gjermanë morën pjesë në kërkimin për të burgosurit e arratisur. Të gjithë, përveç tre vetëve, u kapën sërish. Dy arritën të shkonin në Suedi, dhe njëri në Spanjë.

Hitleri donte që të pushkatohehin të gjithë 73 të burgosurit e arrestuar sërish. Ata përreth tij arritën ta bindin të hiqte dorë nga kjo – në fund të fundit, britanikët mbanin të burgosurit gjermanë të luftës dhe nuk do ta pranonin lehtë masakrimin e oficerëve të tyre. Megjithatë, Hitleri urdhëroi që 50 prej tyre të vriteshin. Ken Rees, i cili ndodhej në tunel kur u zbulua, në vitin 2010 tregoi në një episod të podkastit të BBC-së, Witness History, se kishte dëgjuar që ata që u vranë ishin “nxjerrë dy nga dy ose tre nga tre dhe janë pushkatuar”.

Në versionin e filmuar, të gjithë burrat u dërguan në një fushë dhe u pushkatuan me mitraloz, por realiteti ishte shumë më i pabesë. Libri i Brickhillit tregon se burrat u dërguan në grupe të


vogla në drejtim të kampit fillestar dhe u qëlluan gjatë rrugës. Ai shkroi: “Vrasjet do të shpjegoheshin me faktin se oficerët e kapur sërish u vranë gjatë përpjekjes për të ikur, ose sepse rezistuan, në mënyrë që më pas të mos mund të vërtetohej asgjë”. Të gjitha trupat u dogjën në krematorium, dhe, siç vuri në dukje ministri i Jashtëm britanik Anthony Eden, në një fjalim në Parlament në qershor 1944, arsyeja e vetme për këtë ishte fshehja e mënyrës së vdekjes së tyre.

Bushelli ishte njëri nga burrat që u kap dhe u vra. Ai vdiq në moshën 33-vjeçare. Detajet e vdekjes së tij dolën në hetimin që u bë më pas: bashkë me shokun e tij të arratisjes, u qëllua në shpinë nga oficerët e Gestapos. Hiri u kthye në kamp bashkë me të të tjerëve, por sipas mbësës së tij, urnat u thyen kur trupat aleate përparuan drejt kampit, dhe kështu, më shumë se 80 vjet më vonë ai mbetet ende atje.

Dy nga burrat që arritën të shmangnin ekzekutimin ishin Jimmy James dhe Sydney Dowse. Në një dokumentar të vitit 2012, Dowse tregoi përjetimin e tij si i mbijetuar. “Fillon dhe e pyet veten pse drejtin nuk u vrave edhe ti. Këtë ndjenjë kishim unë dhe Jimmy. Pse nuk na pushkatuan? Mund të na kishin pushkatuar fare lehtë. Ishte thjesht një fat. Dhe ... fat goxha i tmerrshëm”.

Ekzekutimi i 50 të burgosurve të luftës shkaktoi zemërim të madh në Mbretërinë e Bashkuar. Edeni, në fjalimin e tij para Parlamentit, deklaroi: “Qeveria e Madhërisë së Tij duhet, prandaj, të evidencojë protestën serioze kundër këtyre veprimeve të gjakftohta e të egra. Ajo nuk do të ndalë kurrë përpjekjet për të mbledhur provat për të identifikuar të gjithë ata që janë përgjegjës. Është e vendosur që këta kriminelë të neveritshëm të ndiqen deri te njeriu i fundit, kudo që fshihen. Kur lufta të përfundojë, ata do të përballen me drejtësinë e merituar”. Pas luftës, u ndërmor një hetim i gjerë për vrasjet. Si rezultat, u zbuluan hollësitë dhe 13 oficerë të Gestapos u varën për pjesëmarrjen e tyre në ekzekutime.

Gjashtë vjet pas arratisjes, në vitin 1950 Brickhilli botoi rrëfimin e tij për ngjarjen, i cili më vonë u përshtat në filmin e famshëm. Kur Charles Clarke u pyet për mendimin e tij mbi versionin holivudian të ngjarjeve, ai tha: “Pa filmin, kush do ta kujtonte se çfarë arritjeje madhështore ishte ajo”? /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Llapi fiton ndeshjen e parë gjysmëfinale ndaj Drenicës

Podujevë, 10 prill - Skuadra e Llapit ka bërë një hap të rëndësishëm drejt finales së Kupës së Kosovës në futboll, duke shënuar fitore në ndeshjen e parë gjysmëfinale kundër Drenicës, me rezultat 2:0.

Takimi u zhvillua të mërkurën pasdite në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë, në

praninë e tifozëve të të dyja ekipeve. Skuadra vendase e nisi fuqishëm takimin dhe arriti të konkretizojë dominimin që në pjesën e parë. Golin e parë e shënoi mesfushori Arbër Bytyqi në minutën e 29-të. Vetëm shtatë minuta më vonë, Llapi dyfishoi epërsinë, falë një autogoli të mbrojtësit të

Drenicës, Antonio Marku. Në pjesën e dytë, Llapi menaxhoi mirë epërsinë, duke mos lejuar Drenicën të krijojë raste serioze për të rrezikuar portën e tyre dhe kësaj siguroi epërsi të rëndësishme për ndeshjen e kthimit, e cila zhvillohet pas dy javësh në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj.



# FFK-ja dhe Komuna e Prishtinës nënshkruajnë memorandum për organizimin e Ligës së Shkollave

PRISHTINË, 10 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës dhe Komuna e Prishtinës kanë nënshkruar Memorandumin e Bashkëpunimit përmes të cilit do të bëhet organizimi i Ligës së Shkollave në futboll. Memorandumi është nënshkruar nga presidenti i FFK-së, Agim Ademi dhe kryetari i kryeqytetit, Përparim Rama. Ky projekt i rëndësishëm ka për synim promovimin e sportit dhe zhvillimin e talenteve të reja në mesin e të rinjve. "Ky projekt do të implementohet nga organizata "Prishtina Tournament" dhe do të përfshijë 44 shkolla fillore të

ulëta dhe 13 shkolla të mesme të Komunës së Prishtinës. Në këtë iniciativë janë të përfshira edhe Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Sportit si dhe Shoqata e Sporteve Shkollore në Prishtinë, të cilat do të kenë rol kyç në realizimin dhe mbikëqyrjen e kësaj lige", thuhet në njoftimin e FFK-së. Ky memorandum paraqet një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit të aktiviteteve sportive në shkolla dhe përforcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për zhvillimin e brezave të rinj përmes sportit më të dashur – futbollit.



## Kosova mposhtet nga Suedia në Karlskrona



PRISHTINË, 10 PRILL - Në një atmosferë shumë të bukur sportive, të enjten mbrëma në Karlskrona të Suedisë u zhvillua ndeshja e parë mes Suedisë dhe Kosovës. Hendbollistet suedeze kanë shënuar fitore me rezultat 51:16. Nikoqirja ishte favorite e madhe dhe dëshmoi nivelin që e ka, në palestrën "Brinova Arena" të mbushur me shikues. Suedezyt nisën furishëm duke krijuar herët epërsi bindëse. Më pas e kontrolluan ndeshjen deri në fund. Lojtaret e Kombëtares sonë, përkundër angazhimit,

vetëm në momente shfaqën lojë për të rivalizuar deri diku vendaset. Natyrisht, kanë ndikuar edhe mungesat e rëndësishme. Më efikasja te Kosova ishte Merlinda Qorraj me pesë gola. Katër i shënoi Mirela Gjokaj e tri Mirjeta Bytyqi. Ndeshja e kthimit është të dielën nga ora 17:15 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Suedia është Kombëtarja bindshëm më cilësore që paraqitet në fazën e dytë kualifikuese për Kampionatin Botëror të këtij viti. Ishte e para në vazon e parë, kështu që Kombëtaren

tonë nuk e përcolli fati në short. Në dy edicionet e fundit të Lojërave Olimpikë, Suedia ishte në gjysmëfinale. Në Botërorin e vitit 2023 luajti po ashtu në gjysmëfinale, ndërsa në Euro 2024 u rendit e pesta. Kombëtarja jonë në fazën e parë kualifikuese mposhti Belgjikën e Bosnjë-Hercegovinën, por nuk kishte fat në short për fazën e dytë. Gjithsesi prej dy ndeshjeve me Suedinë, Kombëtarja jonë do të mësojë shumë. Do të jetë përvojë e vlefshme për kualifikimet e ardhshme.

## Peja e ndali shkëlqimin e Yllit

PEJË, 10 PRILL - Peja ka dalë triumfuese nga ndeshja e parë çerekfinale të Play-Offit ndaj Yllit duke fituar me rezultat 71:77. Vendasit e nisën ndeshjen më mirë, ku fituan në çerekun e parë me rezultat 23:19, por Peja ktheu avantazhin pasi periodën e dytë e fitoi me 11 pikë më tepër, 11:29. Fundi i pjesës së parë ishte i tensionuar, ku dueli u ndërpre për shkak të

fyerjeve në kor nga ana e tifozëve. Duke shkuar në zhyeshitore, basketbollisti i Pejës Griciunas, ka provokuar tifozët vendas duke e bërë me gishta shkronjën "L". Ky provokim i irritoi edhe më tepër tifozët vendas, të cilët gjuajtën me karrige në drejtim të lojtarëve kundërshtarë. Ylli e zbuti epërsinë e Pejës në çerekun e tretë, të cilin e fitoi me katër pikë diferencë, 19:15, por që

Peja arriti ta ruante epërsinë e krijuar deri në fund, ku periodën e fundit fitoi me rezultat 11:14. Më i miri në parket te Ylli ishte Palokaj me 20 pikë, tre topa të rrëmbyer e pesë asistime, ndërsa te Peja u dallua Griciunas me 17 pikë, 11 topa të rrëmbyer e dy asistime. Ndeshja e dytë çerekfinale e Play-Offit do të luhet pas tri ditësh në "Karagaç" duke filluar nga ora 19:00.



Nis procedura për ndërtimin e stadiumit në Suharekë

SUHAREKË, 10 PRILL - Në kuadër të investimeve strategjike për zhvillimin e infrastrukturës sportive në vend, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka shpallur procedurën për ndërtimin e stadiumit të ri në qytetin e Suharekës. Lajmin e ka bërë të ditur ministri në detyrë i Sportit,

Hajrulla Çeku, i cili ka theksuar rëndësinë e këtij projekti për sportin dhe komunitetin lokal. Sipas ministrit Çeku, për këtë projekt janë ndarë 13 milionë euro, ndërsa stadiumi i ri do të ndërtohet sipas standardave më të larta ndërkombëtare, duke qenë i

kategorisë 2 sipas klasifikimeve të UEFA-s. Stadiumi pritet të ketë kapacitet prej 6,518 ulësesh, duke ofruar kushte moderne dhe të denja për zhvillimin e ndeshjeve vendore e ndërkombëtare. “Një tjetër projekt i madh për infrastrukturën sportive po bëhet realitet. Kemi shpallur

procedurën për ndërtimin e stadiumit të ri të Suharekës. Stadiumi për të cilin kemi ndarë 13 milionë euro, do të jetë i kategorisë 2, me kapacitet 6518 ulëse, dhe plotëson standardet më të larta ndërkombëtare. Sapo të kontraktohet operatori do të nis realizimi i punimeve”, ka shkruar ministri Çeku. Ky



projekt vjen si vazhdimësi e përpjekjeve të MKRS-së për të ndërtuar infrastrukturë të qëndrueshme sportive.

McLaren thumbon Verstappenin: Mund të bëjë diferencën në një garë, por jo gjithë sezonin

SURREY, 10 PRILL - Te McLaren kanë reaguar pas deklaratës së Max Verstappen (Red Bull), fitues në garën e fundit të Formula 1 në Japoni, se me makinën britanike do të dominonte në pistë. Sipas drejtuesve të McLaren, piloti kampion bote bëri diferencën në një garë, por nuk mund ta bëjë këtë gjë përgjatë gjithë sezonit. Andrea Stella, shefi i garave të McLaren, në prag të garës së Bahrein, këtë fundjavë, ka deklaruar: “Sigurisht që Verstappen do të jetë në gjendje të duelojë për fitore në çdo garë. Ai bëri diferencën në garën e fundit, por është shumë e vështirë të vazhdosh kështu për 24 gara në një sezon, nëse nuk ke makinën më të mirë”. “Kushti më i rëndësishëm për të synuar të dy titujt botërorë është të kesh makinën më të mirë. Dhe, në këtë kuptim, është thelbësore të vazhdosh të garosh në mënyrë



solide. Nëse nuk mund të fitosh, atëherë është mirë të përfundosh një garë me të dy pilotët në podium”. “Në luftën për titullin, ne e konsiderojmë Max si kandidat kryesor, ashtu sikurse edhe Russell apo Leclerc e të tjerë. Por, në këtë momente, ne mendoj se kemi makinën më të mirë dhe po e shfrytëzojmë këtë situatë për të grumbulluar sa më shumë

fitore dhe pikë në botëror”, ka shtuar Stella. “Unë mendoj se për momentin jemi ende në një fazë tranzicioni. Hamilton fitoi garën sprint në Kinë, Russell ishte konkurrues në Shanghai, në Suzuka kishim Red Bull dhe Max Verstappen. Ndaj, do të duhet t'i shohim gjërat në një prizëm më të gjerë në të ardhmen”, ka deklaruar Andrea Stella.

Fitojnë Lakersat, Oklahoma mbron kreun në NBA



Dallas, 10 prill - Skuadra e Lakersave rikthehet te fitorja në NBA, pas triumfit me rezultat 112-97 në fushën e Dallasit. Donqiq realizoi 45 pikë ndaj ish-ekipit të tij dy muaj më parë. Fiton edhe skuadra e Toronto, që falë 23 pikëve të Roden mundi me rezultat 126-96 Charlotte.

Zhgënjejnë kampionët në fuqi të Bostonit, që u mundën me rezultat 96-76 nga Orlando, sfidë ku u dallua Wagner me 23 pikë. Fitore të rëndësishme korri Chicago, që mundi me rezultat 119-111 Miami, ndeshje ku të gjithë titullarët e Bulls realizuan mbi 17 pikë. Oklahoma vijon të

jetë lider në NBA, duke fituar edhe sot, me rezultat 125-112 në fushën e Phoenixit. Jalen Williams me 32 pikë ishte shënuesi më i mirë. Jashtë fushe triumfon Denveri, që mundi me rezultat 124-116 Sacramento (Joki triple double, 20 pikë, 12 rebound, 11 asistime).

Ter Stegen: Synoj të rikthehem shpejt të luaj për Barçën dhe Gjermaninë

Portieri Marc-Andre Ter Stegen ende nuk është rikthyer, por po bën gjithçka që mundet për të përshpejtuar rikuperimin e tij nga dëmtimi i gjatë që e shtyu Barcelonën të

nënshkruajë me Wojciech Szczesny në verë për ta zëvendësuar përkohësisht. Portieri gjerman foli për “DAZN”, duke shpjeguar se ai shpreson të jetë në gjendje të festojë rikthimin e tij para

përfundimit të sezonit aktual. “Ky është qëllimi. Për momentin dua të kthehem në ekip dhe në formë të mirë. Kam bërë disa pjesë të punës me ta. Dua të jem në 100% dhe të punoj shumë në ditët e

ardhshme”, ka thënë Ter Stegen, i cili me pas foli edhe për bisedat e tij me trajnerin e kombëtares gjermane Julian Nagelsmann në lidhje me rikthimin e tij. “Ne folëm për këtë. Ai vazhdoi të më

pyeste për gjendjen time. Është shumë e rëndësishme për ne të dy që unë të kthehem për të luajtur për klubin dhe më pas në kombëtare”, shpjegoi portieri 32-vjeçar.

SHKURT

Celtic nuk heq dorë nga transferimi i Rexhbeçajt

Skuadra e Celticut nuk e ka ndërmend të heq dorë nga transferimi i Elvis Rexhbeçajt këtë verë. Bëhet e ditur se është trajneri i Celticut, Brendan Rogers që po insiston ta ketë mesfushorin e Kosovës nën urdhrat e tij. Mësohet se skuadra skoceze tashmë ka ofruar 4 milionë euro për ta bindur Augsburgun në lirin e 27-vjeçarit, i cili ka kontratë me ekipin gjerman deri në vitin 2026. Rexhbeçaj po kërkohet edhe nga Beshiktashi e Parma, por duket se Celticu është favorit për transferimin e tij në verë. Në 26 ndeshje të luajtura këtë sezon, Rexhbeçaj ka shënuar 2 gola dhe ka bërë 1 asistim në të gjitha garat.

Enrique: Mund të përmirësohet akoma më shumë

PSG-ja e mposhti Aston Villan në Ligën e Kampionëve me rezultat 3-1. Trajneri Luis Enrique ka thënë se kjo skuadër mund të përmirësohet edhe me shumë. Kampionët e Francës kanë bërë një hap të madh drejt kualifikimit në gjysmëfinale. “Zhvilluam një lojë argëtuese për tifozët tanë, ne dëshirojmë të arrijmë rezultate të mira me këtë mënyrë loje. Kemi një grup të mirë lojtarësh, të ndërthurur mirë, me djem të rinj të talentuar dhe me lojtarë me eksperiencë. Ne kemi një projekt afatgjatë, mendoj se kjo skuadër mund të përmirësohet akoma më shumë”, u shpreh Enrique.

Lewandowski: Do të shkojmë për fitore edhe në Dortmund

Lojtari i ndeshjes sipas UEFA u vlerësua Robert Lewandowski, i cili realizoi dy gola në fitoren që Barcelona e arriti ndaj Borussia Dortmund (4-0). Sulmuesi polak ka thënë se ende nuk po mendojnë për gjysmëfinale, pasi është edhe një ndeshje për tu zhvilluar. Ai ka paralajmëruar se synojnë fitore edhe në Dortmund. “Mendoj se kemi luajtur mirë, por nuk po mendojmë ende për gjysmëfinalen, është ende një ndeshje për t'u luajtur. Do të shkojmë në Dortmund për të fituar, ky është gjithnjë objektivi ynë. Numrat personal? Jam shumë i kënaqur për këto numra, 99 gola me Barcelonën. Si sulmues duhet të mendosh gjithnjë për të shënuar, por nëse luajmë kështu është më e lehtë”, u shpreh Lewa.

Messi shkëlqen me dy gola e një asistim

Lionel Messi ka shkëlqyer në fitoren e Inter Miamit ndaj Los Angeles FC me rezultat 3-1. Tetë herë fituesi i “Topit të Artë” i realizoi dy gola dhe e bëri një asistim në fitoren e ekipit nga Florida, i cili me këtë rast e siguroi kualifikimin në gjysmëfinale të CONCACAF Champions Cup. Ndeshjen e parë e kishte fituar Los Angeles FC me rezultat 1-0, por Messi me shokë e përmbysën rezultatin dhe tash e shohin veten në gjysmëfinale, me ç'rast do të synojnë ta fitojnë këtë trofe. Ish-futbollisti i Barcelonës e Paris Saint-Germainit në këtë sezon i ka realizuar 8 gola dhe i ka bërë 3 asistime në 9 ndeshje të zhvilluara.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Euro Steel” shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Qendrën e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, në Ramun, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.06.2025 në ora 11:00 në objektin e SHFMU “Haxhi Zeka” në Zahaq, Komuna e Pejës, do të organizohet debat publik nga Kompania “Euro Steel” shpk, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Euro Steel” shpk, Pejë, për Qendrën e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit dhe magazinimit të mbeturinave të letrës, plastikës, qelqit mbeturinave metalike dhe vajrave të përdorura, në Ramun, Pejë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Perlat Recycling” L.L.C. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Qendrën e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit të mbeturinave të metalike, në Harliaç, Fushë Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.06.2025 në ora 09:00 në objektin e SHFMU “Bajram Curri” në Sllatinë të Madhe, Komuna e Fushë Kosovës, do të organizohet debat publik nga Kompania “Perlat Recycling” L.L.C. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Perlat Recycling” L.L.C. Prishtinë, për Qendrën e mbledhjes, grumbullimit, transportimit, trajtimit fizik, ripërdorimit, përpunimit, magazinimit të mbeturinave të metalike, në Harliaç, Fushë Kosovë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Blerta Samadrazha shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu “ Abdyl Frasheri “ Prizren.
- Ibrahim Rasimi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme “ Ymer Prizreni “ Prizren.
- Qendrim Ponik shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Mic Sokoli “ Prizren.
- Qendrim Ponik shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Q.K “11 Marsi “ Prizren.
- Nafis Luta shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Mustafa Bakiu “ Prizren.
- Sellmedin Bazda shpall të humbur certifikatën e biznesit “Nafo Dekor” me nr. 811565491.
- Beqir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesat nga kl. I-VIII të shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Mazrek Has Prizren.
- Hevzi Latifi shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës profesionale “Ymer Prizreni” Prizren.
- Hajrush Gashi shpall të pa vlefshme dëftesën e klasës 1 deri 9 të shkollës fillore “Bajram Curri” në Kurushë të Madhe.
- Demokrat Rizanaj shpall të pa vlefshme diplomën e shkollës së mesme “Gani Çavderbasha” në Prizren.
- Dila Sopjani shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Zef Lushmarku" Fshati Vilezh.
- Arbër Lipoveci nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe diplomën e sh.m. Ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Naim J Gashi, B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr. 811147463 të lëshuar nga ARBK.
- Dulë Gjuraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I, II të sh.f.m.u. “Shaban Gola” Lipavec KK Gjakovë.
- Armir Krasniqi nga Demjan KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Kongresi i Manastirit” Demjan KK Gjakovë nga kl. 1-5 dhe –6-9
- Valon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.
- Arlinda Kalimashi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Albert Mehmeti nga Brovina kk Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl. I të Gjimanzit “Hajdar Dushi” Gjakovë paralele e ndarë në Ponoshec.



ROYAL CROWN

**RC**  
cola

# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA  
Since 1903

Columbus, Georgia, USA  
Since 1903

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

